



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	07.04.2017
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës - Muaji Mars 01.03.2017 – 31.03.2017

DKA edhe gjatë muajit Mars ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

Për nderë të festës së **7 Marsit Ditës së Mësuesit**, DKA ka organizuar takim me drejtorët dhe mësuesit e shkollave në të cilin takim u ndanë mirënjohje për mësuesit e dalluar në nivel shkolle. Gjithashtu është bërë përzgjedhja e punëtorit më të mirë në nivel Komune për vitin 2017. Të gjitha Shkollat e kanë shënuar këtë ditë me organizime festive.

Vizita pune në disa Shkolla.

MASHT ka paraparë që nga muaji shtator i këtij viti të gjitha Shkollat të fillojnë me ndryshimet kurrikulare, e lidhur me këtë disa mësues janë trajnuar për kryetrajnerë dhe trajnerë të cilët do të mbajnë trajnimin për mësuesit parafillor, klasa e parë, klasa e gjashtë dhe klasa e dhjetë.

Kërkesë në Thesar për ndryshimin e Emërimit të Shkollës “Hivzi Sylejmani” në “Dy Dëshmorët” Dobrajë e Madhe.

Kërkesë Drejtorit të Departamentit Komunal në Ministrinë e Financave për rialokimin (transferimin e mjeteve të ndara brenda nënprogramit, nga një nënkategori në tjetrën nënkategori, brenda kategorisë së njëjtë të shpenzimeve të atij nënprogrami).

Pjesëmarrja e zyrtarëve për financa në takimin e organizuar nga MASHT-i në të cilin takim është dikustuar për shpërndarjen e të hyrave vetanake në shkolla, trajnimi i njëjës psikologe për shkrim dhe lexim të Brailit, pastaj takimi për Arsimit gjithëpërfshirës në Komuna si dhe pjesëmarrja zyrtarëve në trajnimin për administrues dhe përdorues të programit për mësimin online.

Njoftim për Sekretarin Përmanent në MASHT dhe menaxherin e ndërtimit të objektit të Shkollës Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan, për defektet që po paraqiten dhe të cilat paraqesin rrezik permanent për nxënësit dhe stafin, si pasojë e mosrealizimit cilësor të punëve nga firma kontraktuese e cila ka ndërtuar objektin në fjalë dhe për të cilën përgjegjëse është MASHT.

Kërkesë për Departamentit e Prokurimit për:

- Zhvillimin e procedurës - servisimin nxemjes qendore në Shfmu “7 Marsi” në Poturoc dhe Shfmu “Drita” në Ruboc, p.n.f në Kojskë.
- Zhvillimin e procedurave - ndërtimi i rrethojave të Shkollave Shfmu “Vezir Kolshi” në Baicë, Shfmu “Emin Duraku” në Banullë, p.n.f në Gumnasellë dhe përfundimi i rrethojës në Shfmu “Ismail Luma” në Baicë .
- Zhvillimin e procedurës - ndërtimi i Shkollës në Shfmu “Nezë Bujani” në Bujan p.n.f në Bregu i Zi dhe Shfmu “Haradin Bajrami” në Magure, p.n.f në Mirenë.

Kërkesë për departamentin e Gjeodezisë dhe Kadastrit për:

- Pajisjen me dokumente për ndërtimin e Shkollës Shfmu “Drita” në Ruboc.
- Pajisjen me dokumente për ndërtimin e Shkollës në Haradin Bajrami në Magure.
- Kompletim të dokumentacionit teknik të parcelës së Çerdhës.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimim në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.